



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.11.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Elisa Spiropali – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019” me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave për çështjet e punës dhe arsimit profesional

(Komision për dhënie mendimi)

2. Shqyrtimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019” me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për çështjet e rinisë

(Komision për dhënie mendimi)

Marrin pjesë:

Elisa Spiropali, Klodiana Spahiu, Ilir Pendavinji, Flamur Golemi, Edlira Bode, Adelina Rista, Arben Kamami, Roland Xhelilaj, Almira Xhembulla dhe Nuri Belba.

Mungojnë:

Petrit Vasili, Orjola Pampuri, Lindita Metaliaj, Vangjel Tavo, Halim Kosova, Bardh Spahia, Floida Kërpaçi dhe Grida Shqina.

Të ftuar:

Dajna Sorensen - Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Silva Banushi - Drejtoreshë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Gentian Opre - Drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor

Genta Prodani - përgjegjëse sektori

HAPET MBLEDHJA

Elisa Spiropali – Mirëdita të gjithëve!

Sot jemi mbledhur për të bërë shqyrtimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019” me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave për çështjet e punës dhe arsimit profesional.

Të ftuar kemi zonjën Dajna Sorensen, zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë, zotin Gentian Opre, drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor, zonjën Silva Banushi, Drejtoreshë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe zonjën Genta Prodani, përgjegjëse sektori.

Në orën 12:00 kemi mbledhje me Ministrinë e Arsimit, ku do të jetë ministrja e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Sot është e rëndësishme që të diskutojmë dy çështje, të cilat kanë qenë me prioritet në programin tonë qeverisës, siç janë çështjet e punës apo tregut të punës dhe çështjet e arsimit dhe formimit profesional, dy sektorë të cilët kanë pasur vëmendjen tonë të vazhdueshme në këto vite dhe me kënaqësi shikoj se ky prioritet elektorale dhe qeverisës është reflektuar edhe në buxhetin e vitit 2019. Konkretisht kemi një rritje me 14% të buxhetit për punën dhe një rritje prej 10,7% të buxhetit për arsimin dhe formimin profesional në krahasim me vitin 2018. Një rritje e konsiderueshme, e cila duhet të shkojë në prioritetet brenda këtyre fushave, por edhe në një përdorim eficient të këtij buxheti me këtë rritje.

Nga raporti dhe relacioni i përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë që ju keni përgatitur për sa i përket buxhetit shikoj se keni prioritetizuar shpërndarjen e buxhetit në disa nga çështjet kryesore, konkretisht në modernizimin e shërbimeve publike të punësimit, rritjen e punësimit të grave, të të rinjve dhe personave vulnerabël. Unë dua t’ju lutesha që në raportin tuaj t’i referoheshit kësaj çështje, që ka ndjeshmëri të lartë për këtë komision, hartimit të politikave dhe programeve që promovojnë punësimin; cilësor, duke rritur kërkesën në punë, produktivitetin dhe punësimin; uljen e papunësisë dhe pasivitetit të lartë, veçanërisht në grupin e grave dhe të rinjve. Konkretisht dua të di se si e keni menduar çështjen e punësimit të të rinjve dhe grave, duke qenë se papunësia e këtyre dy grupeve është më e lartë se mesatarja kombëtare dhe ka nevojë për një politikë të posaçme. Zbatimi i modelit kombëtar të punësimit, modeli i ri i shërbimeve, që ju keni planifikuar në të 36 zyrat e punësimit në Republikë, nëpërmjet riorganizimit të ambienteve të punës, edhe këtu dua që të hyni pak më shumë në detaje në sistemin IT, në modernizimin që u keni bërë zyrave dhe çfarë ofrojnë ato për njerëzit, për riorganizimin e zyrave dhe zhvillimin e burimeve njerëzore. Kjo e fundit është shumë e

rëndësishme, sepse në këto zyra punojnë njerëz, të cilët kanë të bëjnë me njerëz, kanë të bëjnë me njerëz të papunë, me njerëz që kanë frustrim të lartë dhe probleme shoqërore, por mund të kenë edhe probleme të tjera. Është e rëndësishme që njerëzit, të cilët merren me ta të jenë të trajnuar sa më larg modelit militantit partiak dhe sa më pranë modelit të profesionistit.

E rëndësishme është të theksohet buxheti që ju keni planifikuar për programin e ndërmjetësimit dhe çfarë do të thotë. Pra, si e keni planifikuar që ta ndryshoni modelin e ndërmjetësimit dhe pse do të jetë modeli i ri më i efektshëm, sepse një rritje e tillë e buxhetit për punën, 14%, detyron që të kemi shërbime më të mira dhe të ndjeshme; të kemi një përmirësim të ndjeshëm të shërbimit dhe infrastrukturës. Programet e nxitjes së punësimit, të cilat veprojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me grupet vulnerabël.

Në fakt, për sa i përket punësimit, që nga viti 2014 kemi një trend rritës të buxhetit, por ju ndoshta mund ta specifikoni se çfarë është bërë në gjithë këto vite dhe çfarë pritet të bëhet në vitin 2019 me këtë rritje.

Gjithashtu, dua të ndaleni te programet e formimit profesional, sepse e gjithë reforma e ndihmës ekonomike dhe asistencës ka pasur parasysh shkëputjen e këtyre njerëzve nga një program ndihme sociale dhe kalimin në tregun e punës, por ka edhe njerëz që kanë ngelur pas, pra njerëz që kanë rënë në këto hapësira të sistemit. Është e rëndësishme që ne t'i shënjestrojmë sa më mirë persona të tillë. Konkretisht, dua të di, si do të funksionojë programi i formimit profesional edhe për njerëzit që dalin nga skema e ndihmës ekonomike?

Sa buxhet është parashikuar për programin e pagesës së papunësisë për vitin 2019, sepse, sipas të gjitha standardeve dhe ILO-s, nuk duhet të jetë më pak se 50% e pagës minimale? Besoj se ky është një standard, por si reflektohet në këtë buxhet? Dua të na thoni diçka për investimet në zyrat e punësimit, por më shumë se investimet në infrastrukturë dhe në zyra, na flisni për investimet në standard dhe në personat që punojnë pranë burimeve njerëzore.

Pjesa e arsimit profesional, fakti që kemi një rritje prej 10,7% në krahasim me vitin 2018, është shumë inkurajuese për ne. Konkretisht, është e rëndësishme që ju të nxirrni elementet më të rëndësishme. Pra, çfarë nënkupton reforma në arsimin profesional, sa grupe do të mbërrijnë përmes këtij rialokimi të buxhetit dhe planifikimit që ju keni bërë? A përmbushen vizionet e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim, që është një strategji e vitit 2014-2020, dhe në fazën që jemi si e shikoni ju implementimin e kësaj strategjie? Pra, a janë të mjaftueshme këto fonde, a kanë nevojë për rritje të buxhetit? Në lidhje me këtë pjesë, dua që të jeni sa më të hapur. Çfarë synohet të arrihet përmes programit që ju keni bërë për optimizimin e rrjetit të ofruesve, ngritjen e sistemit të kualifikimit, forcimin e lidhjeve me biznesin e me radhë, sepse ndonjëherë programet e aftësimin profesional, na janë dukur sikur

kanë ngelur në letër? E di që ju keni bërë një punë shumë të mirë në këto vite për t'i nxjerrë sa më shumë në pah, por, gjithsesi ka nevojë për një lidhje më të mirë me qytetarët dhe për më shumë informacion.

Fondet që janë parashikuar në buxhet për arsimin e mesëm profesional në tërësi dhe sa është rritur frekuentimi i këtyre shkollave, si parashikohen, si është infrastruktura e me radhë? Pra, a i marrin shërbimet si duhen? A shkollohen ashtu siç duhet në këto shkolla? Rikonstruksionet e shkollave. Shikoj se keni planifikuar rreth 8 rikonstruksione, a janë të plota, a janë të pjesshme, a i mbulojnë nevojat e sektorit? Më pas modernizimi i kuadrit ligjor dhe sa është parashikuar për këtë pjesë?

Fjala për ju, zonja Sorensen.

Më pas deputetët do të bëjnë pyetje dhe do të diskutojnë rreth buxhetit.

Faleminderit!

Dajna Sorensen – Përshëndetje të gjithëve!

Kënaqësi që ndodhem sot këtu për të raportuar në lidhje me buxhetin e arsimit dhe formimit profesional dhe punësimit për vitin 2019.

Unë po e nis si linjë logjike, duke filluar nga ata që ndjekin arsimin dhe formimin profesional, si një mënyrë më e mirë për t'u integruar në tregun e punës në Shqipëri, pra po e nis me arsimin profesional dhe më pas do të vazhdoj me punësimin.

Ashtu siç e përmenda, arsimi dhe formimi profesional është një mundësi shumë e mirë për të rinjtë, të rejtat, por edhe për individët gjatë gjithë jetës për t'u integruar në tregun e punës dhe për të mbetur relevantë në tregun e punës. Domethënë, arsimi dhe formimi profesional nuk duhet parë ekskluzivisht si një mekanizëm që i përket arsimit të mesëm profesional, por është edhe për kualifikimin e vazhdueshëm të të gjithë atyre individëve, të cilët duan t'i mbajnë aftësitë e tyre të përditësuara, për ta pasur hyrjen dhe daljen në tregun e punës sa më të lehtë ndër vite.

Po e filloj me një rezymë se çfarë ka ndodhur gjatë vitit 2018, në lidhje me arsimin profesional.

Së pari, dua të nënvizoj se pjesëmarrja në arsimin profesional në 4 vjetët e fundit ka ardhur vazhdimisht duke u rritur. Në qoftë se ne e krahasojmë me vitin 2013, ku vetëm 13% ishte numri i personave që ndiqnin arsimin e mesëm profesional, sot ndodhemi në një pikë, ku 20,6% e nxënësve në moshën për të ndjekur arsimin e mesëm, ndjekin arsimin e mesëm profesional.

Ndërsa shifrat e frekuentimit të arsimit të mesëm të përgjithshëm kanë ardhur në një rënie relativisht të vogël, falë edhe ndryshimeve demografike. Për sa i përket arsimit dhe

formimit profesional, kemi një rritje të numrit të personave që ndjekin arsimin profesional. Aktualisht, këtë vit mësior janë regjistruar 19 mijë e 296 nxënës, nga të cilët 3100 janë vajza. Domethënë, deri diku kemi një pjesëmarrje relativisht të ulët të vajzave në arsimin profesional, por është diçka që ka ardhur gjithmonë edhe më tepër në rritje.

Për sa u përket drejtimeve mësimore, pra cilat janë drejtimet mësimore, që janë më të frekuentuara dhe për të cilat ka një interes më të lartë. Dua të nënvizoj se në hoteleri turizëm, këtë vit akademik janë regjistruar 1 mijë e 149 nxënës; shërbime mjetesh transporti 784 nxënës; teknologji informacioni dhe komunikimi 574 nxënës, pastaj në vijim ekonomi biznes, elektroteknikë, termohidraulik edhe mekanikë janë programet më të ndjekura.

Në vitin 2018 janë ndërmarrë edhe 9 rikonstruksione të shkollave të ndryshme. Gjithashtu, ju keni një listë me buxhetin respektiv për secilin prej këtyre rikonstruksioneve. Dua të nënvizoj se vetëm “Hoteleri Turizmi” dhe “Gjergji Canco” janë rikonstruksione që do të vazhdojnë edhe në vitin 2019.

Paralelisht me zhvillimet dhe fluksin e madh të nxënësve në arsimin profesional, është shumë e rëndësishme që të ecim edhe me rritjen e cilësisë së arsimit dhe formimit profesional. Kualifikimi i mësuesve është një nga elementët shumë të rëndësishme, për sa i përket cilësisë së arsimit dhe formimit profesional.

Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, që është përgjegjëse edhe për rritjen e kapaciteteve të stafëve të shkollave profesionale, ka ndërmarr trajnimin 24-ditor të mësuesve të lëndëve profesionale. Aktualisht, në vitin 2018 janë trajnuar 114 mësues dhe parashikohet që deri në fund të vitit të kemi 196 mësues të trajnuar.

Gjithashtu, në vitin 2018 janë ndërmarrë 10 përshtime dhe standarde të kualifikimeve profesionale po nga kjo Agjenci.

Për sa i përket buxhetit të vitit 2019, dua të ndalem vetëm në objektivat primare të buxhetit dhe ku do të shkojë ky buxhet, përtej ofrimit të arsimit profesional. Gjithashtu, do të punohet për optimizmin e rrjetit të ofruesve, rritjen e investimeve në sistemin e arsimit dhe formimit profesional, ngritjen e sistemit të kualifikimit dhe të trajtimit të vazhduar të mësuesve dhe përf forcimin e lidhjeve me biznesin.

Për sa u përket treguesve të performancës, kemi tregues të veçantë të arsimit profesional, që kanë të bëjnë me indikatorë, duke filluar nga pjesëmarrja në arsimin profesional, numri i të diplomuarve, çfarë ndodh me të diplomuarit në momentin që ata mbarojnë shkollat e mesme profesionale, a integrohen këta individë në tregun e punës, numrin e nxënësve femra, për të siguruar një barazim gjinor në ndjekjen e arsimit dhe formimit profesional, sikurse edhe integrimin e grupeve të marginalizuara në arsimin dhe formimin

profesional. Për sa i përket pjesëmarrjes së personave që vijnë nga grupe të disavantazuara në arsim profesional, aktualisht në sistem kemi 527 individë, të cilët u përkasin komuniteteve rome dhe egjiptiane, 115 persona me aftësi të kufizuar, 259 të rinj, të cilët kanë përfituar statusin e jetimit, dhe 1922 nxënës, të cilët i përkasin familjeve që janë me ndihmë ekonomike.

Sikurse ju e përmendët, buxheti i vitit 2019 parashikon një rritje të fondeve për arsimin dhe formimin profesional me 10,7%. Konkretisht, buxheti për vitin 2019 arrin në 3,3 miliardë lekë, pra është buxheti më i lartë që është alokuar ndonjëherë për arsimin dhe formimin profesional për 35 shkollat në vend. Rritjet kanë qenë në të gjitha zërat e buxhetit, domethënë jo vetëm rritje në investime, por edhe në zërat e tjerë të buxhetit për të siguruar që të gjitha resurset e domosdoshme për të ofruar një arsimi dhe formim profesional cilësor janë të alokuara.

Ne në relacion kemi parashtruar edhe një listë të shkollave dhe të investimeve të parashikuara për vitin 2019. Gradualisht jemi duke ezauruar të gjitha shkollat e arsimit dhe formimit profesional, jo të gjitha janë rikonstruktuar, por një pjesë e madhe e tyre ndër vite gradualisht janë duke u rikonstruktuar. Mbeten edhe disa shkolla të tjera, që do t'i parashikojmë vitin e ardhshëm, Almira me siguri do t'i përmendë.

Për sa i përket modernizimit të kuadrit ligjor, në këtë rast bëhet fjalë për hartimin e të gjitha akteve të mbetura në zbatim të ligjit "Për arsimin dhe formimin profesional" të kaluar në vitin 2017; rishikimin e programeve ekzistuese dhe zhvillimin e kompetencave të mësuesve dhe instruktorëve, që këto mbeten prioritetet për vitin 2019.

Dua të nënvizoj edhe diçka tjetër, pavarësisht se buxheti është rritur, gjithmonë ka nevoja, të cilat asnjëherë nuk janë shteruese, por ne kemi qenë në këtë komision në lidhje edhe me marrëveshje të shumta në funksion të mbështetjes dhe arsimit dhe formimit profesional. Dua të them se ky sektor është një nga sektorët më të mbështetur nga partnerët tanë ndërkombëtarë, qoftë nga Bashkimi Europian, qofshin gjermanët, zviceranët, austriakët e të tjerë, për të cilët ne kemi ardhur në mënyrë të vazhdueshme në komision për programe mbështetëse. Është shumë e rëndësishme të nënvizojmë faktin se të tria elementet duhet të përputhen bashkë, investimet në infrastrukturë me investimet në kurrikula të reja dhe me aftësi më të mira të mësimeve. Pra, të gjitha këto duhet të punojnë njëkohësisht me njëri-tjetrin, që të arrijmë një arsim profesional të mesëm cilësor.

Me pak fjalë, kjo ishte rezymeja që unë doja t'i jepja arsimit profesional.

Po kaloj te programet e punësimit, sikurse ju e përmendët, punësimi është një nga prioritetet kryesore të qeverisë, është një prioritet që ka të bëjë me tri elemente kryesore.

Së pari, me sigurimin e më shumë vendeve pune për të gjithë ata individë, të cilët janë të gatshëm dhe kanë dëshirë për të punuar.

Së dyti, sigurimi i punëve edhe më cilësore se sa punët aktuale.

Së treti, këto punë duhet të jenë të qëndrueshme. Domethënë, nuk po flasim për integrim temporan të personave në tregun e punës, por të sigurojmë se ata janë në gjendje, së pari, të hyjnë në tregun e punës dhe, së dyti, të qëndrojnë aty gjatë. Ky është elementi i tretë që lidhet shumë ngushtë me

arsimin dhe formimin profesional, sepse njerëzit, në mënyrë të vazhdueshme, duhet të ofrohen me mundësi për t'i mbajtur aftësitë e tyre profesionale të përditësuara, që në qoftë se ka ndryshime në një treg pune, që evoluon vazhdimisht, ata të kenë mundësinë që të jenë të përditësuar dhe të jenë relevantë në tregun e punës.

Gjatë vitit 2018 ka vazhduar zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim, implementimi i së cilës ka filluar që nga viti 2014, sipas planifikimit të aktiviteteve në planin e saj të veprimit. Qëllimi i strategjisë është që të promovojë vende pune dhe aftësi për të gjithë qytetarët e Shqipërisë. Kjo strategji paraqet një nga angazhimet më të forta të qeverisë shqiptare për mirëqenien e qytetarëve.

Në total, deri në fund të vitit 2018 janë rinovuar 21 zyra, janë të qasshme për publikun dhe ofrojnë modelin e ri të shërbimeve të punësimit.

Prioritetet për vitin 2019

Dua të nënvizoj disa elemente: modernizimin e shërbimeve publike të punësimit, rritjen e punësimit të grave, të rinjve dhe personave vulnerabël. Ju do ta shikoni edhe për sa i përket programeve që zbatohen nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit, ne kemi programe specifike që targetojnë gratë vulnerabël në tregun e punës, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë dhe të rejtat që diplomohen, apo personat të cilët nuk kanë eksperiencë të mëparshme në tregun e punës.

Një tjetër element i rëndësishëm, dhe dua ta nënvizoj, është se duke filluar nga viti 2018 të gjitha zyrat e punës kanë pasur target specifik, çdo muaj për numrin e personave që do të ndërmjetësonin në punësim. Këto nuk janë targete të përgjithshme, por janë targete, të cilat janë të disagreguara, sipas vulnerabilitetit të personave në tregun e punës. Domethënë, sa persona me aftësi të kufizuara, sa romë dhe egjiptian, sa gra kryefamiljare dhe vajza nëna e të tjera. Pra, kanë qenë targete të specifikuara shumë mirë, mbi të cilat zyrat e punës janë monitoruar çdo muaj dhe kanë raportuar për to. Për më tepër, ne jemi munduar që, përtej indikatorëve sasior, të integrojmë edhe një sërë indikatorësh cilësorë, ku dua të përmend se sa nga këto ndërmjetësime përfundojnë në punësim formal dhe, së dyti, sa nga këto përfundojnë

në punësime afatgjata. Domethënë, nuk është punësim i përkohshëm, por është një punësim afatgjatë.

Katër janë programet kryesore që zbaton Shërbimi Kombëtar i Punësimit: programi i ndërmjetësimit për punë, programet e nxitjes së punësimit, programi i formimit profesional dhe programi i pagesës së papunësisë. Për periudhën janar-shtator të këtij viti janë realizuar 25 mijë e 486 të punësime. Në qoftë se shikoj shifrat sot, aktualisht janë mbi 29 mijë punësime të realizuara nga zyrat e punës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duke filluar nga fillimi i këtij viti. Domethënë, targeti i tyre për vitin 2018 ka qenë 25 mijë, një target që ata e kanë tejkaluar që në shtator dhe aktualisht ndodhen në 29 mijë persona, të cilët janë ndërmjetësuar në punësim nëpërmjet zyrave të punës.

Dua të nënvizoj edhe një tjetër fakt të rëndësishëm, që zyrat e punës kanë performuar shumë mirë, numri i personave të cilët janë të regjistruar pranë zyrave të punës ka ardhur në një rënie të vazhdueshme. Aktualisht, krahasuar me vitin 2015, kur ka qenë piku më i lartë i numrit të personave të papunë të regjistruar pranë zyrave të punës, ku ka pasur 152 mijë të papunë, sot në zyrat e punës rezultojnë rreth 67 mijë persona, të cilët janë punëkërkues të papunë. Kjo nuk e bënë punën e zyrave të punës më të lehtë, përkundrazi shumë nga këta individë hasin vështirësi të tepërta për t'u integruar në tregun e punës dhe kanë nevojë për një trajtim të specializuar, për të mundur integrimin e tyre në tregun e punës.

Aktualisht janë 8 programe të nxitjes së punësimit, që zbatohen nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

Së pari, ka të bëjë me punësimin e femrave nga grupet e veçanta, ku përfshihen këtu vajzat nëna dhe femra të tjera, të cilat kanë vështirësi integrimi në tregun e punës. Një tjetër program ka të bëjë me formimin profesional në punë, ku u ofrohet të gjithë atyre të rinjve dhe të rejave që nuk kanë pasur eksperiencë të mëparshme në tregun e punës, të përfitojnë aftësi për punë pranë bizneseve ekzistuese.

Programi i tretë është për kategori të tjera vulnerabël në tregun e punës. Gjithashtu, kemi një program të veçantë për jetimët, sikurse dhe një program të veçantë për personat me aftësi të kufizuara.

Deri në tetor të këtij viti në këtë program janë përfshirë 4 mijë e 453 punëkërkues të papunë, nga një target prej 5 mijë personash, që kanë pasur parashikuar për këtë vit.

Për sa i përket programit të formimit profesional, ky program synon trajnimin e punëkërkuesve të papunë të regjistruar në zyrat e punës, me kurse afatshkurtra 3-4-mujore. Për vitin 2018 objektivi ka qenë që rreth 17 mijë persona, nga të cilët 10 mijë punëkërkues të

papunë, do të përfitonin kurse falas pranë 10 qendrave të formimit profesional në Shqipëri. Nga zyrat e punës deri në shtator të vitit 2018 janë formuar rreth 6 mijë 265 punëkërkuar të papunë, që kanë qenë të regjistruar pranë zyrave të punës.

Për sa i përket programit të papunësisë, ky program është pjesë politikave pasive të punësimit, të cilat garantojnë mbështetje me të ardhura për çdo individ që ka qenë i punësuar minimalisht për 1 vit në momentin që ata shkëputen nga puna. Aktualisht, numri i personave që përfitojnë nga programi i pagesës së papunësisë ka ardhur në ulje dhe në këtë moment janë rreth 2700 persona, të cilët përfitojnë nga pagesa e papunësisë.

Një nga obligimet që ka Shqipëria në lidhje me kontratën e mbështetjes buxhetore të Bashkimit Europian ka qenë edhe rikonstruksioni i të gjitha zyrave.

Me buxhetin e vitit 2019 parashikohet konkludimi i të gjitha rikonstruksioneve të zyrave të punës dhe aplikimi i programit ose i shërbimeve të reja të punësimit në të gjitha zyrat e Shqipërisë.

Dua të nënvizoj edhe një element të fundit, dhe do ta mbyll fjalën time, sektori i punësimit të arsimit dhe formimit profesional mbështetet nga Bashkimi Europian, nëpërmjet mbështetjes buxhetore sektoriale, ku Shqipëria ka obligimin që të përmbushë një sërë indikatorësh të performacës së tyre. Sektori i punësimit dhe arsimit profesional ka pasur përmbushjen më të lartë të objektivave për vitin 2016, përmbushja ishte 9 nga 10 indikatorë, për vitin 2017, që u vlerësua në vitin 2018, 6 e gjysmë nga 7 indikatorë. Domethënë, performanca e këtij sektori, edhe në këndvështrimin e partnerëve tanë ndërkombëtarë, ka qenë tejet e lartë.

Në fund të vitit 2018 ne do të konkludojmë edhe vlerësimin e ndërmjetëm të strategjisë dhe do të dalim me një plan pune të përditësuar deri në fund të vitit 2020.

Faleminderit!

Jam e hapur për pyetjet që mund të keni.

Elisa Spiropali – Dua t’ju falënderoj sinqerisht për të dyja relacionet që keni paraqitur: arsimin profesional, tregun e punës dhe punësimin, sepse, përveç shpjegimit të buxhetit, ju keni marrë kohën për të shpjeguar të gjitha programet të detajuara, dhe prezantimi juaj ishte shterues!

Deri tani, nga prezantimet që ne kemi dëgjuar në këtë komision, ju jeni të parët.

Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Bode!

Edlira Bode – Përshëndetje!

Ju falënderoj për prezantimin dhe punën që bëni çdo ditë!

Në fakt, të gjitha këto që thoni janë shumë inkurajuese dhe duket se programet e punësimit janë në rrugë të mbarë dhe besoj se kështu do të vazhdoni.

Kam 2-3 pyetje të vogla për ju, për t'u sqaruar në interes të publikut.

Së pari, në lidhje me qendrat e formimit profesional, ju thatë se kemi 10 qendra të formimit profesional, besoj se janë qendrat e qarqeve më të rëndësishme. A mendoni se janë të mjaftueshme apo gjykoni se mund të jetë e nevojshme që të ngrihen qendra të reja? A e mbulojnë plotësisht territorin? Unë përfaqësoj një bashki të vogël të qarkut Korçë dhe aty nuk ka qendër të formimit profesional. Dua të di, a keni informacion, që kjo qendër arrin të mbulojë edhe territorin më të largët, apo jo?

Në lidhje me personat që marrin pjesë në kurset e formimit profesional, a keni informacion në përqindje, qoftë edhe në numër absolut, sa nga këta arrijnë të punësohen, arrijnë të gjejnë tregun e punës? Më pas, jo vetëm nga qendrat e formimit profesional, por edhe nga të punësuarit me ndërmjetësimin e zyrave të punësimit nëpër bashki, se unë di se një numër jo i vogël, dhe ju na i thatë me shifra, arrin të punësohet. A e monitoroni ju procesin, sa nga këta të punësuar mbeten në punë dhe për sa kohë? Pra, a u lidhet një kontratë pune e përkohshme, disamujore apo mbeten në punë me afat të pacaktuar?

Kam edhe një gjë tjetër, ndoshta është lapsus, por e kam në lidhje me pagesën e papunësisë, që ju thatë, se zgjat deri në 1 vit mbasi një i punësuar humbet punën. E kam me shifrën: thoni 6 mijë lekë, sa gjysma e pagës minimale, që është 24 mijë lekë

(Ndërhyrje pa mikron)

Faleminderit!

Elisa Spiropali – Urdhëroni, zonja Xhembulla!

Almira Xhembulla – Faleminderit, zonja kryetare!

Dua të falënderoj zonjën zëvendësministre dhe të gjithë stafin për informacionin shterues dhe lajmet e mira që na vijnë në drejtim të këtij sektori, i cili lidhet me shtimin e buxhetit për arsimin profesional dhe zbatimin në vijueshmëri të strategjisë për çështjet e punësimit.

Në fakt, u përmend edhe nga zonja Sorensen, pavarësisht se ne shikojmë që kemi rritje të buxhetit, dua të merret në konsideratë edhe kërkesa ime e vazhdueshme për një mbështetje për sa i përket këtij sektori në qarkun e Dibrës, duke qenë se pjesa verilindore, ashtu siç është pohuar edhe nga vetë përfaqësuesja e ministrisë, duke e lidhur me numrin e madh të papunësisë, nivelin e ulët ekonomik dhe me numrin e madh të grupeve që përfitojnë nga ndihma ekonomike, mbetet e ende e zbuluar në këtë aspekt. Kështu që mendoj se duhet të rishikohet ose të merret në konsideratë një mbështetje për rikonstrukcionin e shkollës së mesme

profesionale “Nazmi Rushiti”. Pavarësisht se duhet ta pranoj që aty po punohet, ka një staf të përkushtuar dhe një koordinim të mirë që bëhet mes shkollës dhe degës së Bulqizës dhe ka një numër të qëndrueshëm të nxënësve, mendoj se duhet të ketë më shumë vëmendje për degën e industrisë së minierave në Bulqizë

Ju pohuat se numri i vajzave, të cilat ndjekin arsimin profesional, vazhdon të mbetet i ulët. A mendoni ju se është tipologjia e degëve ajo që nuk çon në një rritje të numrit apo lidhet me nivelin e mirë që kanë vajzat në arsim dhe nuk preferojnë të shkojnë aty?

Së dyti, për sa i përket buxhetit, që lidhet me strategjinë dhe politikën për punën, aty shprehet nxitja e përfshirjes sociale dhe e kohezionit territorial. A mund të na e shpjegoni sesi e keni parashikuar këtë pjesë?

Ndoshta unë nuk e pashë, por ne e kemi diskutuar dhe është prezantuar nga ju mbështetja për qendrat lëvizëse për arsimin profesional, a parashikohet në fond një ndihmë për këto qendra, duke qenë se edhe kolegja Bode u shpreh se në disa zona ku mungon arsimi profesional, ndoshta një aftësim profesional nëpërmjet qendrave lëvizëse të këtij sektori mund të ndihmojë?

Faleminderit!

Dajna Sorensen –Faleminderit!

Disa nga pyetjet kanë pak mbivendosje, kështu që unë do të mundohem t’u përgjigjem bashkërisht.

Për sa u përket 10 qendrave të formimit profesional, këto janë 10 qendra që kanë qenë ekskluzivisht të profilizuara për të ofruar kurse afatshkurtër. Qasja jonë në këtë moment është që qendrat në vetvete kërkojnë investime substanciale, ndërkohë që shkollat janë të pajisura mirë që të hapin dyert e tyre dhe të ofrojnë kurse afatshkurtra kudo ku këto 35 shkolla janë. Domethënë, qasja jonë është që të përdoren ambientet e shkollave për të ofruar jo vetëm arsim të mesëm profesional, por edhe kurse afatshkurtra, që është e gjithë reforma e riorganizimit të ofruesve në atë që ne i quajmë qendra multifunksionale, qendra që ofrojnë edhe arsim profesional, edhe kurse trajnimi.

Aktualisht, në Korçë ne kemi 5 shkolla profesionale dhe një qendër të arsimit profesional, që duhet domosdoshmërisht t’i mbulojë nevojat e gjithë qarkut për sa i përket formimit profesional. Duke iu kthyer edhe asaj që përmendi Almira më parë, realisht varet shumë edhe nga sa proaktive janë vetë këto qendra. Për shembull, unë kam shumë raste pozitive, ku zyra e punës së bashku me qendrën e formimit profesional, siç është Gjirokastra, kanë qenë shumë proaktive, kanë shkuar edhe në zonat rurale dhe kanë bërë vlerësime të nevojave që zonat e caktuara kanë dhe u janë përgjigjur me kurse të krijuara në mënyrë të

posaçme për ato nevoja. Këto praktika të mira domosdoshmërisht duhen përhapur edhe në qendrat e tjera të arsimit profesional në Shqipëri.

Për sa i përket asaj se çfarë ndodh me ata që diplomohen në shkollat profesionale apo në kurset afatshkurtra, ne, duke filluar që nga viti 2016, kemi ndërtuar një sistem të ndjekjes së personave që diplomohen, ku nëpërmjet pyetësorëve ne shohim se ku ndodhen ata pas 6 muajsh që janë diplomuar.

Për sa i përket arsimit të mesëm profesional, ne kemi një inflamacion më të detajuar. 47 % e personave, të cilët përfundojnë arsimin e mesëm profesional janë të punësuar brenda 6 muajve nga momenti që ata janë diplomuar, ndërsa për personat që kanë bërë vetëm trajnim jemi në vlerësim e sipër të kësaj të dhëne, por ajo çfarë ka ndodhur është që numri i personave, të cilët u janë përgjigjur anketimit që ne kemi bërë ka qenë shumë i ulët për të pasur një referencë të drejtpërdrejtë, por jemi duke e përmirësuar në këtë moment dhe për vitin 2018, ata që janë trajnuar, absolutisht që niveli...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Silva Banushi - Qendrat ofrojnë edhe 40 profesione të ndryshme.

Unë dua të shtoj diçka edhe për shkollat profesionale, të cilat kanë dalje edhe në vit të dytë, pra mund të jetë teknik i ulët dhe në vit të katërt merr maturën shtetërore së bashku me maturën profesionale. Kështu që të gjitha qendrat mund të bëjnë kurse 2-vjeçare, 3-vjeçare apo formim të përgjithshëm profesional, që është matura shtetërore.

Dajna Sorensen- Për sa i përket pyetjes se çfarë ndodhë me punëkërkuesit e papunë, të cilët asistohen nëpërmjet zyrave të punës për t'u integruar në tregun e punës, ne jemi duke ndërmarrë *tracing* në mënyrë të vazhdueshme dhe po monitorojmë se ç'përqindje e tyre aktualisht janë të punësuar. Kjo ka qenë diçka që zyrat e punës nuk e kanë bërë më parë, por ne jemi duke e përfshirë në indikatorët cilësorë të zyrave të punës dhe, përveç rritjes së numrave në agregat, të sigurojmë që ky punësim të jetë i qëndrueshëm dhe afatgjatë.

Më falni për lapsusin e pagesës së papunësisë, shumë ndjesë!

Për sa i përket pyetjes së pjesëmarrjes së vajzave dhe tipologjisë së profileve, që Almira ngriti si shqetësim, pjesëmarrja e vajzave ka filluar të rritet. Diçka që kemi ndërmarrë është se për të gjitha ato vajza, të cilat marrin përsipër të shkojnë dhe të ndjekin profile, që nuk janë tipike për vajzat, ato do të marrin bursë. Domethënë, kjo është një mënyrë incentivuese për t'i çuar vajzat në profesione që janë atipike, ose që konsiderohen...

Elisa Spiropali – Cilat janë këto profesione?

Dajna Sorensen –Për shembull në ndërtim, elektromekanikë dhe shërbim mjetesesh transporti. Të gjitha këto degë, të cilat janë të ndjekura tradicionalisht vetëm nga djemtë, ne u ofrojmë bursa vajzave për të ndjekur këto degë.

Për sa u përket qendrave lëvizëse, deri diku u përgjigja.

Për sa i përket nxitjes së kohezionit territorial dhe social, këtu i referohet njërit prej pilarëve kryesorë të strategjisë, asaj Kombëtare për Arsimin dhe Formimin Profesional, e cila ka katër shtylla kryesore, ku njëra prej të cilave është kjo.

Vlerësimi i vazhdueshëm që i është bërë zbatimit të Strategjisë në vlerësimin e përvijshëm që ne ndërmarrim mbetet shtylla me nivelin më të ulët të zbatimit dhe një nga arsytet e kësaj është mosnjohja domosdoshmërisht në detaje e problematikave që ekzistojnë.

Plani i ri i riparë i Strategjisë do të përqendrohet në këtë shtyllë të strategjisë për të elaboruar më mirë dhe për të konkluduar në masa konkrete pikërisht për të përmirësuar kohezionin social dhe territorial.

Elisa Spiropali – Duke qene se ne kemi planifikuar edhe dëgjuesën me ministren e Arsimit, le t'i mbledhim të gjitha pyetjet bashkë dhe ju t'u jepni një përgjigje.

Fjalën e ka zonja Spahiu, pastaj zoti Pendavinji.

Klodiana Spahiu – Së pari, dua t'ju falënderoj, sepse është e vërtetë që bashkë kemi ndarë shumë marrëveshje dhe mbi të gjitha, që është shumë i rëndësishëm, ligji, të cilin e kemi kaluar jo më shumë se para një viti.

Kjo është një mënyrë e re sesi trajtohet arsimi profesional dhe, që në momentin që u shkëput nga Ministria e Arsimit, të gjithë kemi qenë të dyzuar sesi do të jenë rezultatet dhe bashkëpunimi. Tashmë ka kaluar faza, për të cilën ne jemi të sigurt që kjo ishte rruga më e mirë për të rritur shkallën e punësimit dhe mbi të gjitha për të rritur shkallën e kualifikimit në bazë të nevojave të tregut.

Së pari, ne kemi bërë seminare të vazhdueshme në lidhje me buxhetimin gjinor. Si është pasqyruar buxheti gjinor në të dy materialet që keni sjellë?

Së dyti, bazuar në miratimin e ligjit, dua të di se sa nga aktet nënligjore janë miratuar deri tani?

Ju, në fjalën tuaj përmendet që keni një regjistër të atyre që marrin një certifikatë kualifikimi të shkallëve të ndryshme dhe një nga detyrat e Agjencisë Kombëtare dhe Arsimit Profesional është edhe kryerja e studimeve për gjurmimin e të diplomuarve. A ka ndonjë studim konkret për këtë?

Eksperienca që ju përmendet, rasti i Gjirokastrës, ku arsimi profesional ishte i lidhur edhe me kërkesat e tregut të punës, lidhet edhe në bazë të zhvillimit si rajone, sepse jo të gjitha

rajonet mund t'i kenë njëlloj kërkesat e punësimit, sepse në Durrës kërkesat mund të jenë më të larta në degën e turizmit dhe peshkimit. Si mendoni ju, a ka ndonjë studim sesi do të jenë të shpërndara këto kërkesa që ne kemi në lidhje me arsimin profesional për territore të ndryshme të Shqipërisë, sepse, në fund të fundit, është edhe kohezioni territorial dhe social që ne kërkojmë?

Dua t'ju falënderoj për rindërtimin e shkollës “Beqir Çela”, që është një nga shkollat më të mira profesionale dhe për buxhetin e parashikuar për vitin 2019, që i shkojnë qytetit të Durrësit për shkollën profesionale.

Ilir Pendavinji – Meqenëse e kemi kohën të limituar, dua të them vetëm dy gjëra.

Në programin e ndërmjetësimit për punë shikoj se këtë vit do të ketë 292 milionë të parashikuara. Ku shkojnë këto lekë, ndërkohë që tregu për punësimin është rritur me 14% në krahasim me vitin 2018? Para dy javësh kishim në komision Inspektoratin e Punës në një seancë dëgjimore dhe pyetja ishte nëse u mjaftojnë këto lekë, sepse ata referuan që me atë fonde mbulojnë vetëm 4% të territorit.

Lidhur me nxënësit që mbarojnë shkollën e mesme, a i keni gjurmuar se sa nga këta kanë vajtur në shkollë të lartë? Sepse kam idenë se këtu shkojnë nxënës me nivel shumë të ulët dhe nuk e di se si shkojnë me përgatitjen profesionale të tyre. Sa cilësore është kjo?

Faleminderit!

Dajna Sorensen - Ka ngelur në mentalitet se cilësia e nxënësve që shkojnë në arsimin e mesëm profesional është realisht më e ulëta e të gjithë nxënësve që ndjekin shkollën e mesme, por ne kemi shembuj, nuk janë norma, shumë të rëndësishëm, siç janë disa shkolla shumë të kërkuara dhe mesatarja që ndjekin arsimin e mesëm profesional është shumë e lartë. Këtu dua të përmend shkollën “Hermang Majner” në degët teknologji informacioni dhe komunikimi, ku nota mesatare është mbi 9, të ngjashme janë edhe shkolla e Kamzës dhe e Turizmit, që janë shkolla super të kërkuara.

Për sa u përket akteve nënligjore, një pjesë e tyre nuk kanë proceduar, sepse ende nuk ka kaluar ligji i nxitjes dhe kjo ka penguar miratimin e një pjese të akteve nënligjore, që kanë të bëjnë me krijimin dhe funksionim e Agjencisë Kombëtare të Arsimit të Aftësisimit dhe Punësimit.

Për sa i përket studimit nëse ne po u përgjigjemi nevojave të tregut, ne në vitin 2017 kemi ndërmarrë një anketë të bizneseve në Shqipëri për të kuptuar se cilat janë vendet e reja në tregun e punës dhe çfarë mungesash kanë në aftësi. Presupozohet se të dhënat nga ky studim na asistojnë ne për të orientuar ofertën e arsimit dhe formimit profesional dhe kurseve afatshkurtra.

Për sa u përket shpenzimeve për programin e ndërmjetësimit, këtu bëhet fjalë për shpenzime administrative. Domethënë është stafi i SHKP-së, që mundëson që fondet të mos shkojnë tek individët dhe bizneset, por vetëm te procesi i ndërmjetësimit, që organizohet nëpërmjet stafeve të SHKP-së. Lidhur me buxhetin e Inspektoratit të Punës, është një zë buxhetor më vete, të cilin më duhet ta shikoj dhe t'ju kthej një përgjigje me shkrim.

Flamur Golemi – Faleminderit!

Nuk po zgjatem shumë te pjesa makro, sepse kolegët e ezauruan, ndoshta fondet dhe nevojat janë më të mëdha për nxitjen e punësimit, por dua të bëj një pyetje që e kam bërë edhe para një viti lidhur me shkollën profesionale Gjirokastër, ku ndarja e objektit është në inventarin e bashkisë dhe baza materiale është në ministri. Konkretisht, kam kërkuar hapjen e degës së hoteleri-turizmit, sepse degët janë të njëjtat me ato të pas viteve '90 dhe nevojat kanë ndryshuar, por ende nuk është hapur. Ky qytet ka nevojë për shërbim dhe kjo degë është shumë e rëndësishme.

Ju falënderoj që është parashikuar rikonstrukcioni i kësaj shkolle, por edhe konvikti ka nevojë për rikonstrukcion, sepse konviktet ende janë të zaptuar nga banorët.

Faleminderit!

Dajna Sorensen – Kërkesën për hapjen e degës Hoteleri-Turizëm, në vitin e ardhshëm akademik ne do ta konsiderojmë në varësi të kërkesës së studentëve, që janë të interesuar për këtë degë. Kjo ka qenë një praktikë tipike në shumicën e shkollave, që, nëse ka një numër të caktuar individësh të interesuar për të ndjekur atë degë, ne nuk i kemi mbyllur rrugët për të ofruar atë profil. Në rastin konkret, Gjirokastra, nuk ka një degë të tillë, por shkolla e Sarandës mund të përmbushë nevojat për studentët e Gjirokastrës. Atje ka konvikt dhe ofrohen bursa për nxënësit që vijnë nga Gjirokastra.

Faleminderit!

Elisa Spiropali- Në qoftë se nuk ka pyetje apo komente të tjera, unë dua t'ju falënderoj për prezantimin!

Zoti Nuri Belba ka diçka për të shtuar.

Nuri Belba – Kam një pyetje lidhur me zyrat e punës, që mbulojnë bashkitë. Deri tani në zonën tonë një zyrë pune mbulon dy bashki dhe problemi është se të gjithë që trajtohen me ndihmë ekonomike janë të detyruar që çdo muaj të paraqiten te zyra e punës për të marrë një vërtetim nëse janë apo jo në punë. A ka mundësi që një punonjës i zyrës së punës në Librazhd të shkojë në Përrenjas dhe të bëjë këtë punë nëse është e pamundur të hapet një zyrë atje?

Pyetja tjetër lidhet me sistemimin në punë të personave me aftësi ndryshe. Në zonën tonë ka persona që kanë mbaruar shkollën e lartë me nota të mira. A ka zyra e punës ndonjë

program që i ndërlidh me operatorët, të cilët mund t'i punësojnë? Unë kam dy raste konkrete, të cilat kanë mbaruar degën kimi Ushqimore me notë mesatarë 8,5, master shkencor, dhe nuk janë të sistemuar. Për ne ky është problem.

Adelina Rista –Së pari, dua të falënderoj zonjën Sorensen bashkë me ekipin për paraqitjen e projektbuxhetit!

Unë dua të përqendrohem tek arsimi profesional, për të cilin ju falënderoj për çdo gjë që është bërë në Republikën e Shqipërisë!

Vëmendja e qeverisë është e përqendruar tek arsimi profesional si një nga burimet kryesore të punësimit dhe po përmend dy degët bazë të shkollës së mesme bujqësore, që janë agronomia dhe veterinaria. Janë hapur shumë degë të reja, si hoteleri, turizëm e të tjerë, por një pjesë e madhe e popullsisë jeton në fshat, në zonat rurale, të cilët jetojnë me prodhimet bazë, blegtori dhe bujqësi. Unë dua të di se sa nxënës të zonave rurale ndjekin studimet në degët agronomi dhe veterinari? Meqenëse po hapen degë të reja, hoteleri, turizëm e të tjerë, degët agronomi dhe veterinari janë në rritje apo në rënie?

Faleminderit!

Dajna Sorensen – Do t'ju jap një përgjigje shumë të shpejtë.

Për sa u përket zyrave të punës dhe shtrirjes së tyre në bashki të tjera. Sistemi elektronik i SHKP-së mundëson që ata individë nuk kanë nevojë të paraqiten te zyrat e punës për të marrë vërtetimin që janë të papunë, sepse kjo bëhet në mënyrë elektronike nëpërmjet sistemit të ndihmës ekonomike dhe sistemit të SHKP-së.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Absolutisht që duhet të paraqiten një herë në muaj. Ne po shohim një modalitet të mundshëm bashkëpunimi midis zyrave të punës dhe sporteleve të bashkive, që të kenë një person përgjegjës në ato bashki ku nuk ka aktualisht shërbime punësimi.

Për sa i përket pyetjes së dytë, që kishte të bënte me personat me aftësi të kufizuar, ne kemi një program të veçantë për personat me aftësi të kufizuar dhe ndoshta ky është momenti i duhur që mund të na referoni kontaktet e personave dhe të shohim mundësitë për t'i integruar në këtë program.

Për sa i përket ndjekjes së shkollave profesionale nga nxënës të zonave rurale, aktualisht pjesëmarrja në arsimin profesional nga nxënës të zonave rurale është 40%. Nuk di t'ju them specifikisht për degët që ju përmendet, por jam e sigurt që numri i nxënësve ngelet në të njëjtat nivele ku ka qenë para 2-3 vjetësh. Nuk kemi reduktim të numrit të nxënësve në degët bujqësore, qoftë agronomi apo veterinari, përkundrazi, ka pasur një rritje të numrit të vajzave. Specifikisht po përmend shkollën e Golemit, e cila ka ekskluzivisht profil bujqësor.

Elisa Spiropali – Duke falënderuar deputetët për pyetjet dhe ju për prezantimin, ju uroj punë të mbarë dhe uroj që kjo rritje në buxhet të reflektohet edhe në përmirësimin e punës suaj për të ofruar sa më shumë shërbime për njerëzit dhe për t’u qëndruar më pranë atyre!

Faleminderit

Sekretar
Klodiana Spahiu

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretare e komisionit
Joana Bitri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.11.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Elisa Spiropali – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi në parim i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019” me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për çështjet e rinisë.

Marrin pjesë:

Elisa Spiropali, Klodiana Spahiu, Ilir Pendavinji, Flamur Golemi, Edlira Bode, Adelina Rista, Arben Kamami, Roland Xhelilaj, Almira Xhembulla dhe Nuri Belba.

Mungojnë:

Petrit Vasili, Orjola Pampuri, Lindita Metaliaj, Vangjel Tavo, Halim Kosova, Bardh Spahia, Floida Kërpaçi dhe Grida Shqina.

Të ftuar:

Lindita Nikolla – Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Mirela Bimo - Drejtoreshë në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar

Florian Nurçe - përgjegjës në Sektorin e Buxhetit në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar

Maringlen Mertiri - këshilltar në kabinetin e ministres

Solara Jaupaj - këshilltare në kabinetin e ministres

Elisa Spiropali – Mirëdita, zonja Ministre!

Ju kërkojmë shumë ndjesë për vonesën, por, ishte një dëgjese në vazhdim dhe pyetjet e deputetëve marrin kohë.

Faleminderit që keni ardhur!

Sot diskutojmë për buxhetin e vitit 2019 me ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, specifikisht për çështjet e rinisë, që janë fushë e kompetencës së këtij komisioni.

Buxheti i arsimit për vitin 2019 është 3,2% e prodhimit të brendshëm bruto. Sigurisht që është një buxhet që ka pasur rritje në vazhdim, por mbi të gjitha ka pasur një cilësi të përdorimit të këtij buxheti nga ministria për sa i përket rritjes së cilësisë së arsimit, dhe kjo është e dukshme, por edhe investimit në infrastrukturë, në të gjitha zonat, pavarësisht nëse janë në qendër apo periferi. Ka pasur një rritje të cilësisë së mësimdhënies përmes disa reformave, siç është portali “Mësues për Shqipërinë”, por edhe një sërë masash të ndërmarra për mësuesit që ishin jashtë profilit dhe një vëzhgim më i hollësishëm i cilësisë së mësuesve në territor.

Ne jemi shumë të interesuar të dëgjojmë nga ju projektet që keni për rininë, reformat, ligjin e ri, si dhe buxhetin për vitin 2019, që sigurisht është modest, ashtu siç, në pikëpamjen time, ka qenë gjithmonë buxheti i rinisë. Megjithatë, nuk duhet parë vetëm çështja e rinisë, por duhen parë edhe investimet e tjera që bëhen dhe përmirësojnë thelbësisht jetën e të rinjve, sepse ajo është e rëndësishme, duhen specifikuar investimet në sport, por edhe në terrenet e ndryshme, si qendrat rinore e me radhe.

Financimi për rininë, për sa u përket aktiviteteve, është 33,4 milionë lekë në këtë buxhet. Ndoshta duhet edhe një detajim nga ju sesi është planifikuar të shpenzohet ky buxhet dhe cilat janë prioritetet për rininë për vitin 2019 dhe në vazhdim.

Fjala është për ju, zonja Ministre!

Faleminderit!

Lindita Nikolla –Faleminderit, e nderuar kryetare!

Faleminderit, të nderuar koleg!

Pa dyshim që ky është një moment shumë i rëndësishëm i komunikimit dhe debatit shterues në gjithçka që buxheti i ri për vitin 2019 mëton të sjellë në të gjithë sektorët, por specifikisht edhe në sektorin e arsimit.

Patjetër që unë jam këtu për t’iu përgjigjur të gjitha pyetjeve që lidhen me programin e rinisë, sa dhe si ky buxhet i adreson problematikat e evidentuara specifikisht në programin e rinisë, por më lejoni të përsëris, ashtu sikurse ju e thatë, që buxheti që i dedikohet arsimit dhe sportit është një buxhet që i dedikohet rinisë, sepse është kjo grupmoshë që buxheti mundëson

një cilësi të re arsimimi në arsimin parauniversitar, është kjo grupmoshë që buxheti i ri adreson një cilësi të re formimi në arsimin e lartë dhe sigurisht edhe në programet e dedikuara jo vetëm mundësisë që do të krijojë ligji i ri për arsimin e lartë, për të cilin unë kam rastin të komplementoj të gjithë skuadrën e arsimit, e cila jo vetëm po bën një ligj për rininë për herë të parë në vendin tonë, por po e bën atë në bashkëpunim me të rinjtë dhe të rejtat, duke i rënë kryq e tërthor të gjithë vendit dhe duke zhvilluar takime me të rinjtë dhe të rejtat në 12 qarqet për të dëgjuar problematikat e tyre dhe mënyrën sesi e shikojnë zgjidhjen e problemit të tyre në ligjin tonë për rininë.

Më lejoni t'ju them se ky buxhet është rritur me 792 milionë lekë më shumë se 1 vit më parë, edhe pse kur adresohet buxheti që i dedikohet arsimit lihen jashtë disa specifika të cilat lidhen me shërbimin arsimor që ka të bëjë me buxhete të cilat adresohen pranë pushtetit vendor që kanë përgjegjësi arsimin parashkollor. Jashtë lihet edhe fakti që ky buxhet do të rritë pagat e mësuesve me 7%. Shuma prej 1,3 miliardë nuk figuron në këtë buxhet, pasi është një grant që lëvrohet nga Ministria e Financës, dhe shkon për përmirësimin e shërbimit arsimor.

Do të kemi përfundimin e rikonstruksionit të 65 shkollave. Kjo do të thotë se do të kemi një cilësi të re për sa i përket komponentit fizik të institucioneve tona arsimore. Gjithashtu, kemi një buxhet që do të adresojë edhe 25 kantiere të reja për 25 shkolla të reja të arsimit parauniversitar, duke adresuar të gjitha problematikat që janë vërejtur në sistemin arsimor për sa u përket kushteve fizike.

Përtej shifrave buxhetore, më lejoni të përsëris atë që tha raporti i fundit i Bankës Botërore, pra që Shqipëria është kampione (kjo do të thotë që ne duhet të ulim më shumë kokën) në mënyrën sesi po e adreson buxhetin, në reformat e ndërmarra në të gjithë sistemin arsimor në raport me të gjitha vendet që kanë shifra të njëjta të zhvillimit apo buxhete të njëjta për arsimin. Kjo është një mundësi për të thënë se sa dhe si ne i jemi përgjigjur besimit që ka dhënë publiku qeverisë së Edi Ramës për reformat e ndërmarra në arsim. Nga ana tjetër, jemi të vetëdijshëm se kemi ende shumë për të bërë që të mundësojmë një sistem arsimor të krahasuar me standardet më të mira të Europës që të vijojmë proceset integruese.

Të nderuar kolegë deputetë, ky vit i ri akademik filloi me një situatë të re për sa u përket disa problematikave shqetësuese lidhur me punësimin e të rinjve, sepse mundësuam funksionimin e 47 programeve të reja dyvjeçare në sistemin tonë të arsimit të lartë, ku janë regjistruar rreth 1655 të rinj. Kjo do të thotë se për dy vjet ne do të mundësojmë që 1655 të rinj dhe të reja t'i atashohen tregut të punës dhe të kenë sukses, duke përmbyllur në mënyrë shumë më të shpejtë një hendek të madh midis ofertës akademike dhe nevojave të tregut të punës. Kjo është një mundësi e re që reforma jonë në arsimin e lartë u ka dhënë të rinjve e të rejave për

punësim, e cila nuk u ofron thjesht një moment të pakënaqshëm, që lidhet me cilësinë e diplomave të tyre, thjesht për të shmangur papunësinë rinore dhe për ta kaluar këtë kohë në universitet. Shifrat e para tregojnë se këtë vit arsimi i lartë ka një pamje krejt të re, duke adresuar për të rinjtë dhe rejat mundësi reale diplomimi edhe për ata, që ndoshta e kanë të pamundur për shkak të aftësive të bëhen mjekë, inxhinierë, mësues, të kenë mundësi të ndjekin studimet e tyre të larta në kolegjet profesionale. Këtu e kam fjalën për programe në fusha të ndryshme që zhvillohen jo vetëm në arsimin e lartë privat, por edhe në atë publik. Ata shumë shpejt do ta gjejnë tregun e punës.

Për sa i përket programit të sportit dhe rinisë, edhe sporti është një fushë ku të rinjtë e të rejat kanë hapësirat e tyre për të zhvilluar talentin dhe mundësitë. Ky program kap shifrën 1,7 miliardë lekë. Në vitin 2019 janë parashikuar 500 milionë lekë, 566 milionë lekë në vitin 2020 dhe në vitin 2021 janë parashikuar 650 milionë lekë. Ky është një parashikim i parë në buxhetin afatmesëm, por buxheti i dedikuar për sportin e rininë për vitin 2019 është 500 milionë lekë, nga të cilat 26,8 milionë lekë janë shpenzime personeli për agjencitë e sportit dhe rinisë, 223,2 milionë lekë janë shpenzime korrente operative dhe 250 milionë lekë janë shpenzime kapitale. Besoj se ky buxhet do të mundësojë jo vetëm funksionimin e agjencive, të Shërbimit Kombëtar të Rinisë dhe të shërbimeve të tjera të ndërtuara në qendrat rinore në disa qarqe të vendit, por do të përmbushë edhe angazhimin e Shqipërisë për funksionimin e projektit të përbashkët në kuadër të projektit “Rajko”. Nga ana tjetër, ky buxhet mundëson në vlerën e 150 milionë lekëve edhe shpenzime kapitale që lidhen jo vetëm me ngritjen e qendrave të reja rinore, por edhe të projekteve dhe programeve rinore, të cilat specifikisht janë evidentuar gjatë komunikimit dhe gjatë aktiviteteve të organizuara me fokus të posaçëm rininë.

Më lejoni t’ju bëj me dije se në buxhetin e arsimit të lartë ne kemi dedikuar një buxhet për kartën studentore dhe jemi duke bashkëpunuar me Bashkinë e Tiranës dhe me institucione të tjera, në mënyrë që t’i japim një zgjidhje shteruese edhe këtij problemi, i cili ka vite që diskutohet, por ende nuk është zgjidhur.

Këto janë në vlera të përgjithshme gjithçka që përmban buxheti i ri. Fakti që fusha e rinisë ju bashkëngjit Ministrisë së Arsimit dhe Sportit është një arsye e fortë që programet rinore nëpërmjet komunikimit, kontakteve dhe projekteve specifike rinore problemet që dalin të gjejnë zgjidhje, duke funksionuar me energjinë e përbashkët të programeve të arsimit dhe të sportit, në mënyrë që të kemi jo vetëm formim dhe jetë të shëndetshme të të rinjve dhe të rejave, por zëri i tyre gjithnjë e më shumë të jetë pjesë e reformave tona dhe i gjithçkaje që përcaktojmë si prioritet dhe objektiv.

Ligji i ri i rinisë patjetër që do të ketë një fushë të re veprimi, por edhe përgjegjësie, ku aktorët kryesorë do të jenë të rinjtë dhe të rejtat dhe do ta angazhojë me më shumë përgjegjësi jo vetëm Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, por besoj gjithë qeverinë shqiptare. Mënyra sesi po hartohet është për t'u përshëndetur, sepse edhe ky është një risi dhe një standard në politikëbërje, duke komunikuar me të rinjtë e të rejtat në 12 qarqet e vendit jo vetëm në qytete, por edhe në fshatra, sigurisht pa lënë pas dore edhe institucionet ku formohen të rinjtë, pra universitetet në të gjithë vendin.

Të nderuar kolegë deputetë, më lejoni të përshëndes të gjithë angazhimin tuaj në realizmin e këtij buxheti dhe të gjitha detyrat e programeve qeverisëse, por edhe angazhimin tuaj specifikisht në monitorimin e punëve se si dhe sa dresohen e shpenzohen këto buxhete të taksapaguesve shqiptarë. Besoj se jemi të qartë dhe të vetëdijshëm që edhe ky buxhet do të shërbejë për të shëndoshur dhe për të përmbushur objektivat tanë, ashtu sikurse jam e vetëdijshme për të dhënë llogari për çdo qindarkë që shpenzohet në fushën e rinisë, por edhe të arsimit e sportit para jush, komuniteteve dhe publikut të gjerë.

Faleminderit!

Elisa Spiropali – Faleminderit, zonja Ministre!

Dua të shpreh keqardhjen e thellë që opozita mungon në një takim të tillë dhe në dëgjuesat për buxhetin. I kemi dëgjuar shpesh në konferenca shtypi të flasin për çështje të rinisë, edhe për ligjin për rininë, edhe për kartën e studentit, edhe për çështje të tjera, ndërkohë që mund të vinin në këtë komision dhe të diskutonin me ministren për t'i ngritur çështjet edhe institucionalisht dhe për t'i ndjekur në vazhdim. Mungojnë... Kësaj nuk kemi ç't'i bëjmë, sepse nuk e zgjedhim dot opozitën, por mund të bëjmë punën tonë mirë për ta çuar një hap më tej këtë proces që ka nisur. Unë bie dakord që ky është një proces konsultimi në të gjithë territorin dhe kjo është po kaq e rëndësishme sa edhe vetë ligji, sepse i bën të rinjtë pjesë e procesit dhe është e rëndësishme që buxheti për rininë të mos shihet i ndarë, pra jo vetëm si fond për aktivitetet që bëhen për rininë, po si një qasje tërësore për të përmirësuar jetën e të rinjve qoftë në bankat e shkollës në të gjithë procesin e arsimit, qoftë në palestrat që po ndërtohen apo në shkollat, të cilat kanë nevojë dhe po plotësohen me staf sportiv apo me infrastrukturën e duhur. Pra, ta shohim si një përpjekje tërësore të të gjithë faktorëve për të përmirësuar cilësinë e jetës së të rinjve në vend. Ndonjëherë është e vështirë t'i mbajmë të rinjtë në një territor të caktuar, është shumë e vështirë për shumë shtete të Ballkanit, të cilat kanë edhe më shumë fonde se ne dhe janë pjesë e BE-së, siç janë Bullgaria dhe Rumania, ku të rinjtë zgjedhin të ikin në një vend, sepse kanë më shumë mundësi, sepse paguhen më mirë, por e rëndësishme është që ne të përpiqemi të ndërtojmë sensin e komunitetit dhe sensin e përkatësisë së këtyre të rinjve edhe

në shkollë, edhe jashtë saj. Zgjedhjet e tjera u përkasin atyre. Përpjekja jonë duhet të jetë maksimale që ata ta ndiejnë veten pjesë e një komuniteti të shëndetshëm.

Besoj se deputetë kanë çështje apo pyetje. T'i bëjmë pyetjet të gjithë me radhë, pastaj ministrja apo stafi do të japin përgjigje.

Zonja Rista.

Adelina Rista – Faleminderit, zonja Ministre për paraqitjen!

Unë shoh se një pjesë e mirë buxhetit të rinisë shkon tek aktivitetet sportive, tek aktivitetet e ndryshme për rininë, te financimi i projekteve në vazhdim, që kanë nisur në vitin 2018 etj. Unë do t'i bie shkurt: a është parashikuar ngritja e qendrave rinore, sepse këtu lexoj se është financimi i tri qendrave rinore? Qendrat rinore ekzistuese do të pajisjen me mjete apo do të ndërtohen qendra të reja? Nëse do të ndërtohen qendra të reja, ku do të ndërtohen ato?

Faleminderit!

Elisa Spiropali – Zonja Ministre.

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Bëhet fjalë për ngritjen e tri qendrave të reja rinore që u shtohen qendrave ekzistuese. Ato do të ngrihen, bazuar edhe në marrëveshjet paraprake që ne kemi me bashkitë, në qarkun e Lezhës, në Kurbin, një në Elbasan dhe tjetra në Lushnjë. Jemi në procesin ku kemi dakordësuar me bashkitë mjediset ku do të funksionojnë këto qendra. Kemi edhe vendimmarrjen e këshillave bashkiakë në këto tri bashki. Procesi tashmë është i hapur për të vijuar me investimin me ambicien që këto të jenë qendra që gëlojnë nga aktivitetet nga debati dhe nga shuma nisma e ide që burojnë nga të rinjtë e të rejtat.

Elisa Spiropali – Zoti Golemi.

Flamur Golemi – Faleminderit, kryetare!

Falënderoj ministren dhe stafin e saj!

Në fakt, sot më shumë se kurrë për sa i përket fondit e buxhetit pjesa që duhet t'i alokojmë rinisë është shumë e rëndësishme. Kam një pyetje direkte për zonjën ministre. Në vitin 2014 është miratuar Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë. Nuk e di pse nuk është zbatuar sot ky plan. Ne nuk duhet thjesht të ndërmarrim nisma dhe t'i hedhim thjesht në letër, por duhet t'i zbatojmë.

Për sa i përket pyetjes që bëri kolegja për qendrat rinore, nuk është problemi thjesht që ato qendra të jenë të hapura thjesht fizikisht, por sa funksionalë janë ato.

Duke kaluar në nivelin mikro, dua të them diçka për qarkun e Gjirokastrës. Universiteti i Gjirokastrës ka problemet e tij. Ju keni thënë dhe kemi diskutuar bashkë edhe herë të tjera për ambientet të cilat janë shumë të kufizuara. Atje është aktualisht ish-Shtëpia e

Oficerëve, e cila aktualisht është në inventarin e Ministrisë së Arsimit. Jam dakord që ka nevojë për ambiente të reja, por të paktën për pjesën e qendrës rinore çfarë mund të bëjmë konkretisht në këto ambiente. Ka shumë nevojë edhe Tirana, edhe Durrësi, por të paktën në periferi Dibra, Gjirokastra të kenë aktivitete. Në momentin kur i kemi studentët t’i mos i bëjmë thjesht në auditorin e shkollës, por edhe më pas, sepse i japin jetë dhe aktivitet edhe qytetit.

Faleminderit, zonja Ministre!

Lindita Nikolla – Unë nuk e di se ku e keni matur vëzhgimin tuaj që thoni se Plani Kombëtar nuk funksionin, sepse e kundërta është e vërtetë. Sot nuk është moment, por unë jam e gatshme që në një dëgjese me komisionin tuaj t’ju them pikë për pikë se si është zbërthyer Plani Kombëtar në një plan veprim dhe çfarë ka ndryshuar në të gjithë aktivitetin falë edhe faktit që në krye të këtij Plani Kombëtar dhe gjithë komponentëve që lidhen me rininë kemi një zëvendësministër jo vetëm të talentuar, por një djalë shumë të përkushtuar për t’i përfaqësuar dhe për të qenë zëri dinjitoz i të rinjve e të rejave në të gjithë Shqipërinë, që është absolutisht një vlerë e shtuar në të gjithë funksionimin e Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit.

Nga ana tjetër, nuk e di se ku e mbështesni mendimin që shpreheni se këto janë qendra thjesht fizikisht të hapura. Nuk e di se sa herë i keni vizituar. Unë jo vetëm i kam vizituar në cilësinë e ministres, por dua të them se kam qenë e ftuar në aktivitete të detajuara dhe kam parë për një mënyrë krejt ndryshe të organizimit dhe të veprimtarisë së qendrave rinore. Dua të them se shpeshherë janë shumë hapa para edhe mënyrës sesi i organizojmë në aktivitetet tona, ku banorë të komunitetit, të rinj e të reja, por jo vetëm, edhe shumë organizata partnere kanë bërë të mundur që në këto qendra të kemi shumë ide, projekte, por dhe buxhete të shumta jo vetëm nga buxheti i shtetit, por edhe nga donatorët për të zgjidhur dhe për të adresuar problematika të caktuara.

Nëse flasim për universitetin e Gjirokastrës, më lejoni t’ju informoj të gjithë ju, të nderuar deputetë dhe ju, zoti Golemi, se universiteti i Gjirokastrës këtë vit ka nisur me një specifikë të re, pra më funksionimin e disa programeve të reja, të cilat besoj se janë një mundësi e re për të rinjtë e të rejtat për t’u formuar pikërisht në ato degë e profile që Gjirokastra dhe rajoni ka interes, sepse ambicia jonë dhe reforma jonë në arsimin e lartë gjithnjë e më shumë po kërkon që universitetet e rajoneve të kenë një peshë specifike dhe të kthehen në qendra të zhvillimit rajonal. Është e vërtetë që universiteti i Gjirokastrës këtë vit rrezikoi disa programe në mësuesi. Unë kam raportuar publikisht edhe në praninë e drejtuesve më të lartë të universitetit të Gjirokastrës. Në fakt, nuk duhet parë si një moment rreziku për këto programe, por duhet parë si një moment kthese për të rinjtë e të rejtat që zgjedhin këto programe për t’u

arsimuar, sepse kontributi i universitetit të Gjirokastrës, referuar vetëm një standardi, atij të cilësisë në provimin e licencimit, 66% e studentëve që ishin formuar në këto programe ishin mbetës. Ndaj, edhe universiteti i Gjirokastrës, edhe reforma jonë e arsimit të lartë, falë këtij bashkëpunimi ka bërë të mundur që ne të mos formojmë mësues apo studentë që nuk performojnë në cilësinë që do të donim. Nga ana tjetër, në programet e reja që universiteti i Gjirokastrës ka hapur ne kemi prurje dhe mundësi reale për punësimin e shumë të rinjve e të rejave.

Për sa u përket ambienteve dhe aseteve që ju thoni, patjetër që ne do ta shikojmë mundësinë. Mbështetja e qeverisë për institucionet e arsimit të lartë ka qenë dhe do të vijojë të jetë maksimale. Besoj se ne do ta adresojmë shqetësimin që ju keni. Që universiteti të jetë i hapur dhe të funksionojë si një qendër debati, komunikimi, aktiviteteve dhe projektesh patjetër që ka vëmendjen e posaçme të Ministrisë së Arsimit, por, mbi të gjitha, është një përgjegjësi dhe një detyrim i vetë institucionit të arsimit të lartë, që funksionon në kushtet e një autonomie të zgjeruar dhe në respekt të plotë të lirisë akademike.

Faleminderit!

Elisa Spiropali – Zoti Golemi.

Pastaj zonja Bode.

Flamur Golemi – Faleminderit për përgjigjen!

Sigurisht që jemi të hapur dhe mund të bëjmë një dëgjues për Planin Kombëtar të Veprimit për Rininë. Në bazë të informacionit tim, mbase e kam gabim, nga 48 pika, vetëm 10 pika janë zbatuar. Unë e thashë edhe më parë, po flas për qendrat rinore ne terren, pra janë fizikisht, por nuk janë marrë përsipër, siç e kam parë vetë.

Për sa u përket universitetit të Gjirokastrës, sigurisht unë ju falënderoj për mbështetjen tuaj! Nisma për ta çuar notën mesatare në 7 për mësuesinë është një gjë shumë pozitive. Jam shumë dakord dhe nuk i heq asnjë presje asaj që u tha për nivelin që duhet ngritur. Sigurisht, ky ka qenë një universitet që mësuesinë e ka pasur në traditën e vet. Unë besoj se duhet të vazhdojmë të rritim nivelin dhe standardin mësimdhënies dhe të studentëve që dalin nga ky universitet.

Faleminderit! Besoj se do të shihemi sërish.

Edlira Bode – Ndoshta në terrene dhe në lokalitete të ndryshme edhe perceptimi, edhe funksionimi është i ndryshëm. Në përvojën time qendra rinore e Korçës funksionin siç thatë ju. Aty ka aktivitete vërtet të admirueshme dhe të shumta në numër. Në fakt, na bën pak ziliqarë ne përfaqësuesve të zonave më periferike fakti që këto qendra rinore janë vetëm në pak qendra të qarqeve. Unë gati u tërhoqa nga pyetja kur bëri pyetjen Adelina nëse do të ngriheshin qendra

të tjera. Kur dëgjova që do të ngrihen edhe 3, do të doja të ishin 61 qendra të tilla në Shqipëri, për çdo bashki. Në Bashkinë e Devollit mungon një qendër e tillë. A e shikoni ju mundësinë që të paktën edhe at, ku nuk mund të kemi një qendër rinore me të gjitha asetet infrastrukturore apo ato me burime njerëzore si në këto qendra që funksionojnë, të ketë një qendër më të vogël, e cila të menaxhohet nga të njëjtët persona, por edhe aty të kemi aktivitete? Flamuri tha që ka ambiente në Gjirokastrë, por ambiente ka edhe në Devoll. Mendoj se ambienti mund të gjendet lehtësisht në çdo bashki. Nëse kjo është çështje buxheti për burime njerëzore, mund të organizohemi edhe duke nxitur shërbimin vullnetar të të rinjve të apasionuar, në mënyrë që të kemi funksionimin e qendrave të tilla edhe në periferi.

Faleminderit!

Elisa Spiropali – Fjalë e ka zonja Xhembulla.

Almira Xhembulla – Faleminderit, zonja Ministre!

Sigurisht, sot vijmë me një lajm shumë të mirë që ka të bëjë me hapat konkretë lidhur me hartimin e ligjit për rininë. Ky është një ligj i cili duhej tashmë të kishte ardhur në tavolinat tona, por më mirë vonë se kurrë. Duke pasur parasysh edhe shqetësimet që u ngritën nga disa kolegë këtu, mendoj që ky ligj do të jetë pikërisht një instrument shumë i mirë për të bërë një koordinim të të gjitha strategjive dhe planeve që lidhen me këtë target grupi, i cili është target grupi më vital dhe më cilësor i shoqërisë sonë. Në fakt, unë ndiej pak keqardhje dhe më vjen keq, sepse ndoshta një komunikim jo i mirë Bashkisë së Peshkopisë nuk bën të mundur që të hapej qendra rinore në qarkun e Dibrës. Ndoshta ju mund të keni një informacion më të detajuar për këtë. Mendoj se si një ndër prej qarqeve më të largëta dhe me probleme që lidhen me uljen e interesit të të rinjve e studentëve cilësorë për t'u rikthyer dhe për ta ngritur jetën e tyre në zonat nga vijnë do të ishte një element shumë i mirë për të rritur interesin për zonën dhe për të gjallëruar jetën e atyre të rinjve në këtë qytet. Ju thatë se tashmë është vendosur se ku do të ngrihen këto qendra rinore. Besoj se ndoshta me një koordinim të mirë që mund të bëni ju edhe me donatorë të ndryshëm mund të rritet numri i këtyre qendrave. Ndërkohë, patjetër edhe aty ka një ambient që deri para disa kohësh ka shërbyer si qendër rinore. Në këtë aspekt, kam informacionin që diçka nuk shkoi mirë ndërmjet strukturave lokale. Mendoj të sjell në vëmendje, meqenëse jemi një qark që për arsye të ndryshme, por edhe të infrastrukturës, dhe numrit të ulët të të rinjve të mirarsimuar që kthehen në Dibër, do të doja ta merrnit në konsideratë.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Patjetër që vëmendja jonë nuk është thjesht për mirëfunksionimin e qendrave rinore në qytete qendër/qarku, por për funksionimin e komunikimit dhe të gjithë shërbimit që lidhet me problematikat e rinisë në çdo territor. Falë detyrës dhe përgjegjësisë që unë kam si ministre e Arsimit, dua t'ju them se nuk janë vetëm qendrat rinore ato që janë pika kondensimi të gjithë këtij debatit shterues që lidhet me problematika të rinisë në qarqe të caktuar. Mos harroni funksionimin e shkollave si qendra komunitare, sepse këto shkolla funksionojnë në të gjithë territorin e vendit. Nuk janë vetëm qytetet qendër/qarku, por është i gjithë qarkun, ku kemi një shpërndarje në territor të funksionimit të shkollave si qendra komunitare. Fakti i ekzistencës së një shkolle qendër komunitar nuk lidhet thjesht dhe vetëm me faktin që këto shkolla do të funksionojnë pas përfundimit të mësimin me aktivitete të larmishme kulturore, sportive e me radhë, por është një tjetër vizioni mbi të cilin funksionojnë shkollat si qendra komunitare, është pikërisht kthimi i institucionit të shkollës pa mure ndarëse. Kjo do të thotë jo vetëm auditorët e shkollave, klasave të shkollave, mjediset të funksionojnë për komunitetin, por është e rëndësishme që i gjithë debati që lidhet me problematika të caktuara të rinisë apo të target grupeve të ndryshme të adresohet në shkollë dhe shkolla të ofrojë për komunitetin projekte, ide, por edhe komunikim që lidhet me këto problematika. Sigurisht, nuk mund të jetë shterues dhe ju ndoshta jeni dyshues, por të gjitha institucionet që masin funksionimin e shkollave si qendra komunitare jo vetëm flasin për objektiva të realizuar, por, nëse i referohen Shqipërisë, në raportet europiane ky projekt është sjellë në vlerën e një modeli për t'u përfshirë edhe shtete të tjera, të cilat e kanë arsimin ndoshta edhe më të zhvilluar se ne për faktin se nis një komunikim i ri. Nëse ne duam ta impaktojmë shoqërinë me standarde, me vlera, me shprehi dhe me qëndrime të krahasueshme me demokracinë europiane cilësohet se shkolla është vendi më i paqtë ku këto aftësi, qëndrime dhe shprehi mund të formohen. Ky është një komponent që ndoshta do të mbushë atë vakuumin e mosekzistencës në të gjithë territorin të qendrave rinore.

Nga ana tjetër, po ju bëj me dije se ne ende nuk kemi një draft të përfunduar të ligjit të ri të rinisë, por është parë dhe do të adresohet në ligj edhe komponenti i pushtetit vendor. Ne ndoshta nuk mund të ngremë qendra të mëdha rinore, por adresimin e një zyrë rinore në çdo bashki do të jetë një komponent që do të vijë edhe për shkak të zbatimit të ligjit të ri të rinisë. Ky është një proces që do të përmbushet hap pas hapi. E rëndësishme është që ne nuk do të krijojmë vakuume, duke e parë komponentin e rinisë si një program të veçantë, por është një program që merr jetë në funksionalitetin e arsimit dhe të sportit në të gjithë sistemin tonë dhe në të gjithë objektivat, aktivitetet dhe treguesit me të cilët ne matim punën e ministrisë, që unë kam nderin të drejtoj.

Për t'iu përgjigjur deputetes, është e vërtetë që nuk patëm një vendimarrje nga këshilli bashkiak i Bashkisë së Dibrës, sepse kishim adresuar ngritjen e qendrës rinore atje dhe jo në Lushnjë. Fakti që nuk u përgjigjën në kohë krijoi shumë shqetësim për ta ngritur këtë qendër, por nuk do të thotë që e kemi mbyllur diskutimin dhe debatin me bashkinë dhe këshilltarët e saj. Është një proces që vijon. Ne themi 3 në momentin që flasim, por ndërkohë jemi duke adresuar edhe me partnerë, edhe me financim të huaj më tepër qendra rinore në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Faleminderit!

Roland Xhelilaj - Do të doja t'ju bëja një pyetje: rezultatet që parashikohen të arrihen në periudhën afatmesme 2019-2021 realisht tregojnë përpjekjet serioze që bën qeveria dhe drejtpërdrejt Ministria e Arsimit për ta çuar përpara këtë fushë shumë të rëndësishme, ku brenda saj përfshihet edhe rinia.

Kisha një pyetje që lidhet me arsimin parashkollor, duke ditur që është një nga funksionet më të kushtueshmet që ka pasur ministria, e cila u është transferuar bashkive. Besoj se nga fillimi i vitit që vjen, kryesisht bashkitë do të merren drejtpërdrejt me trajtimin e problemeve të arsimit parashkollor. Objektivi që ju keni vënë është shumë i rëndësishëm; rritja e aksesit të fëmijëve 3-6 vjeç për të ndjekur arsimin parashkollor të shkojë në nivelin 85%. Cili është roli i ministrisë me pushtetin vendor dhe deri ku shkon ky transferim, në qoftë se ekziston mundësia për një informacion, meqë kemi rastin ta kemi prezent ministren?

Për rininë kisha një pyetje: ka një objektiv për periudhën 2009-2021 që të rrisë pjesëmarrjen e të rinjve në programin e praktikave të punës nga 600 në 900 deri në vitin 2021. Çfarë përfshijnë këto praktika pune?

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Ju falënderoj për pyetjen!

Është absolutisht e vërtetë që programi i kësaj qeverie e ka kthyer në prioritet arsimin parashkollor, sepse investimi në moshë të hershme është jo vetëm *trendy* sot kudo në botë, e përkthyer kjo në vlera monetare “1 dollar i investuar në moshë të hershme i kthehet pas shoqërisë në mënyrë të drejtpërdrejtë në 7 dollarë dhe në mënyrë indirekte kjo mund të shkojë edhe në 14 dollarë”, por fakti që ne kemi adresuar 3,8 miliardë lekë buxhet pranë pushtetit vendor, që lidhet me cilësinë e shërbimit në arsimin parashkollor, duke çuar edhe 4400 edukatorë nën varësinë e bashkive, nuk do të thotë që jemi dorëhequr nga ky shërbim, ndaj detyrat tona lidhen, së pari, me mundësinë tashmë të realizuar, sepse është një standard i kurrikulës së re për çdo fëmijë nga 3-18 vjeç. Deri në vitin 2015 Shqipërisë i ka munguar një kurrikul e integruar për këtë grupmoshë fëmijësh.

Po ashtu, nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit janë realizuar standardet e arsimit parashkollor, që është një risi e vlerësuar edhe nga UNICEF-i dhe nga organizma të tjerë, ashtu sikurse kemi edhe një specifikim dhe përgjegjësi të shtuar që lidhet me kualifikimin e të gjithë stafit të edukatorëve.

Një problematikë që na vjen si shqetësim nga institucionet e arsimit parashkollor ka të bëjë me faktin që pushteti vendor e shikon ende këtë si një përgjegjësi për të punësuar, hequr dhe futur edukatorë në sistem duke krijuar çarje të gjithçkaje që kemi ndërmarrë në unifikimin jo vetëm të standardeve, por edhe në procesin e kualifikimit të stafit të edukatorëve. Procesi i përmirësimit që i bëmë ligjit të arsimit parauniversitar i detyron edhe bashkitë që, kur të zgjedhin për të punësuar në arsimin parashkollor, të përzgjedhin nga sistemi i portalit “Mësues për Shqipërinë”, i cili garanton që të mos kemi edukatorë jashtë profilit, por njëherësh edhe meritën përmes rankimit që arsimi parashkollor ka në këtë portal.

Është shumë e rëndësishme, dhe unë përfitoj jo vetëm nga pyetja juaj, të bëj me dije që, nëse ne nuk do ta shohim investimin në moshë të hershme si një prioritet, kemi pak gjasa që të performojmë mirë në ciklet e tjera të shkollimit në arsimin bazë, arsimin e mesëm të ulët apo arsimin e mesëm e të lartë. Në këtë këndvështrim ne, pushteti vendor dhe kushdo tjetër të angazhohen në mënyrë që t’u mundësojmë shumë më tepër akses fëmijëve në kopshte, më shumë cilësi edukimi në arsimin parashkollor, që më pas të garantojmë suksesin e tyre, si edhe nxjerrjen nga varfëria të fëmijëve që u përkasin shtresave të varfra, po ashtu një performancë krejt tjetër kur ato të jenë pjesë e arsimit parauniversitar.

Për sa u përket kopshteve, në buxhetin që i adresohet arsimit parauniversitar kemi buxhet që i adresohet pajisjes së kopshteve me mjete didaktike, komform kurrikulës së re dhe standardeve të reja të edukimit në arsimin parashkollor.

Për sa u përket praktikave të punës së institucioneve qendrore vendore, sivjet ka pasur risi pasi kësaj eksperience iu bashkuan edhe institucione të tjera bankare, por edhe më gjerë, ku të rinjtë dhe të rejat bëjnë një vit praktikë pune dhe 200 prej tyre zgjidhen për t’u punësuar me një kontratë 1-vjeçare pune, gjë e cila jo vetëm është mirëpritur nga të rinjtë, por ka shërbyer edhe për institucionet tona për të parë sa dhe si performojnë të rinjtë që dalin nga universitetet. Mendojmë se nga 600 të rinj këtë vit, ky numër do të rritet dhe besoj se kjo gjë do të garantojë një mundësi të re për më shumë të rinj dhe të reja që vijnë nga universitetet. Gjithashtu, kemi edhe një buxhet që adreson praktikën profesionale të mësuesve që dalin nga universitetet, që është kusht ligjor që më pas ata të marrin licencën në profilin e mësuesisë.

Elisa Spiropali – Besoj se pyetjet që bënë deputetët shteruan një pjesë të debatit për buxhetin.

Nëse nuk ka pyetje tjetër, ju falënderoj, zonja Ministre, së bashku me stafin tuaj për energjinë dhe dëshirën që rrezatoni për ta çuar përpara arsimin! Besoj se është një nga themelet sesi ky vend mund të dalë nga krizat e veta historike të prapambetjes. Nuk ka mënyrë tjetër për t'u zhvilluar përveçse të investojmë sa të mundemi në arsim.

Jam shumë dakord me ju për atë që thatë për arsimin e hershëm. Të gjitha studimet dhe hulumtimet tregojnë se një fëmijë merr më shumë, mëson apo investon më shumë në karakterin e tij për të ardhmen në periudhën 3-6 vjeç sesa mund të investohet në shkollën e mesme. Kështu që është e rëndësishme që për të gjitha fazat e zhvillimit të një fëmije dhe një të riu, të kemi të njëjtin kujdes, në mos më shumë kujdes, së pari, për arsimin parashkollor dhe më pas atë universitar.

Dua t'ju falënderoj edhe për vëmendjen dhe hapësirën që i keni dhënë rinisë. Ligji i ri për rininë besoj se do të jetë një mënyrë për ta kthyer vëmendjen dhe debatin publik te nevojat që kanë të rinjtë në të gjithë territorin për t'i parë ata si një pjesë e rëndësishme, për të mos thënë pjesa më e rëndësishme e zhvillimit të një vendi. Edhe prindërit punojnë që fëmijët e tyre të kenë një të ardhme më të mirë duke rritur cilësinë e edukimit të tyre, që është koncept më i gjerë se arsimi. Fondet shkojnë për aktivitetet e tyre kulturore jo vetëm në qendrat e qyteteve por edhe në periferitë më të largëta. Këtu dua të jap edhe një shembull ku shkolla e Kolonjës "Papa Kristo Negovani" funksion mirë si qendër komunitare. Me investimin e ri që është bërë në këtë shkollë dhe në shumë shkolla të tjera, vura re që ata gjimnazistë kishin dëshirë të rrinin në shkollë edhe pas orëve të mësimi.

Pra, Qendra Rinore është një gjë dhe po t'i kthejmë shkollat për fëmijët në një mundësi edhe argëtimi edhe formësimi të disa cilësive të tyre të tjera përveçse cilësive akademike, do t'i bëjë ata më të dashur me territorin dhe për rrjedhojë do të duan të frekuentojnë më tepër edhe shkollën.

Ndoshta do të ishte mirë që buxheti për rininë të ishte pak më i lartë edhe në krahasim me pjesën e buxhetit që i shkon Ministrisë së Arsimit, por edhe në tërësi me buxhetin, por ky është një debat për t'u bërë në një vend tjetër.

Shumë faleminderit juve dhe stafit tuaj!

Punë të mbarë dhe suksese!

Lindita Nikolla - Më lejoni t'ju falënderoj, zonja kryetare, për gjithë angazhimin tuaj personal jo vetëm në pozicionin e drejtueses së këtij komisioni, por edhe në gjithçka që keni bërë si model rinor dhe më pas kontributi për të rinjtë dhe të rejtat që të jenë të përfaqësuar apo zëri juaj të jetë një zë i fortë për të zgjidhur hallet dhe shqetësimet tuaja, më lejoni edhe në planin personal t'ju them një vlerësim të posaçëm funksionimi, sepse vij nga një komision

tjetër, që jo shpesh janë seanca të tilla ku njerëzit dëgjojnë, së pari, e ku sigurisht pyetjet kanë thelb dhe adresojnë problematikat reale larg dëshirës për të bërë *show* dhe për të thënë gjëra që nuk konvenojnë me realitetin.

Ju falënderoj të gjithëve, të nderuar, për mundësinë që më krijuat, sepse vij nga një përvojë ku mund të rrimë 6 apo 7 orë në komision dhe ku ministrja që është ftuar për t'u dëgjuar mund të flasë edhe 16 minuta për këto 6 orë, kështu që ju falënderoj edhe për këtë model.

Faleminderit!

Elisa Spiropali - Mirupafshim! Kështu i paçim gjithmonë komisionet!

Do të votojmë në parim projektbuxhetin, meqenëse ditën e mërkurë kemi dëgjesat me grupet e interesit. Kemi një listë të shoqatave kryesisht, por edhe sindikata që kanë kthyer përgjigje në raport me buxhetin dhe ato të cilat na i kanë nisur me shkrim janë ftuar të mërkurën në komision për t'i prezantuar. Ajo do të jetë një seancë e gjatë, kështu që është mirë që ne ta votojmë sot.

Grupet e interesit të cilat kanë sjellë komentet dhe sugjerimet janë:

Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë "Save the Children", Universiteti i Mjekësisë Tiranë, Shoqata e të Verbërve, Rrjeti i Fuqizimit të Grave, Shoqata e Sindromës Down, Shoqata e Invalidëve të Punës, Shoqata e Fëmijëve "Ndihmoni jetën".

Nëse ju kanë kontaktuar grupe të tjera interesi, ju lutem përcillini që të kemi mundësi t'i ftojme në dëgjesën e gjatë të së mërkurës.

Vazhdojmë me votimin në parim të buxhetit.

Hedhim në votim projektbuxhetin për vitin 2019.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Ditën e mërkurë mbledhja do të zhvillohet në orën 10.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA